



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-17246/21
Kaçanik, 25.06.2021

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VII-të (Shtatë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VI e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 25 Qershor.2021. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e KPF prej 7 anëtarëve sa ka KPF, pjesëmarrës në mbledhje morën fillimisht ishin 5 anëtarë: Kemal Mërseli, Nexhat Loku, Pranverë Loku-Zharku, Ekrem Kyçyku, dhe Rabije Sallahi. Në ndërkohë në mbledhje erdhi edhe anëtari, Selim Reka, kështu që konstatohet së pjesëmarrës të kësaj mbledhje ishin 6 anëtarë. Në mbledhje mungoj pa arsye anëtarja, Hafize Sallahi

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë; Nënkryetari i Komunës – Ylber Bajra, drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi dhe Festim Neziraj. në pjesën e fundit të mbledhjes mori pjesë edhe, Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Nga zyrtarët ishte, Fatlume Guri- Selimi, fillimisht edhe Arbnora Kuka.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e VII-të (Shtatë) të Rregullt të KPF-a për vitin 2021, data 25 Qershor, me këtë;

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës (KABK) për vitet 2022-2024;
3. Propozim Rregullorë e brendshme për përdorimin e automjeteve zyrtare; dhe
4. Zëvendësimi i anëtares së KPF nga NISMA, Hafize Sallahi pas kalimit të saj në subjekt tjetër politik- AAK; dhe
5. Propozim Vendimi për rialokim të mjeteve, sipas buxhetit të vitit 2021.

Kryesuesi i Kuvendit, Pika e 5 shtohet me Kërkesën e drejtorit të DEFZH për rialokim të mjeteve. Materialin e keni marrë edhe për këtë pikë, atëherë lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 5 pikëve.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas rendit të punës;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF njëzëri pa vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së VI-të (Gjashtë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë: 10.06.2021 /Lënda: 01Nr. 60/02-15767/21

2. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës (KABK) për vitet 2022-2024;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, është një material bukur i gjerë, drejtori është prezentë në mbledhje, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Ne LVV do të diskutojmë në mbledhjen e KK për draftin kornizë.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që drafti kornizë ti adresohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

**Kornizën Afatmesme Buxhetore e Komunës (KABK) për vitet 2022-2024;
; dhe e njëjta i,**

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

3. Propozim Rregullorë e brendshme për përdorimin e automjeteve zyrtare

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka hapi diskutimin e kësaj draft rregulloreje: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë draft rregulloren e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Rregullorë e brendshme për përdorimin e automjeteve zyrtare; dhe e njëjta i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Zëvendësimi i anëtares së KPF nga NISMA, Hafize Sallahi pas kalimit të saj në subjekt tjetër politik- AAK;

Kryesuesi i Kuvendit, Hafize Sallahi edhe publikisht në mbledhje të KK kërkoj të bëhet zëvendësimi i saj me një anëtar nga NISMA. Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë a jeni të bëhet zëvendësimi i Hafize Sallahi në KPF me një anëtarin nga NISMA, Bekim Koxha ? Për zëvendësimin e saj votuan njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF i,

Rekomandon

Kuvendit të Komunës, zëvendësimin e anëtares Hafize Sallahi me anëtarin Bekim Koxha nga NISMA, për shkak të kalimit të saj në subjekt tjetër politik AAK.

5. Propozim Vendimi për rialokim të mjeteve, sipas buxhetit të vitit 2021;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, drejtori është prezent në mbledhje për dhënë sqarime të nevojshme. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë Propozim Vendimin e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për rialokim të mjeteve, sipas buxhetit të vitit 2021; dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Kryesuesi i Kuvendit, Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora: 11:17. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët e KPF të cilët morën pjesë në këtë mbledhje.

Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 30 Qershor 2021 në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Makfire Malsiu



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

Kemal Mërseli